



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

---

**UDHËZIME PËR DREJTORITË KOMUNALE TË  
ARSIMIT PËR REALIZIMIN E MËSIMIT ONLINE  
PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA (SHML)**

Prishtinë, Mars, 2020

## HYRJE

Pas ndërprerjes së mësimet për shkak të pandemisë COVID-19, MASHTI ka filluar zbatimin e mësimet në distancë për klasat 1-9. Ky mësim është realizuar në mënyrë të centralizuar për shkak të moshës së fëmijëve dhe për shkak të shtrirjes gjeografike (përfshirë edhe në zonat më të largëta) të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Ky mësim realizohet nga mësimdhënësit e përzgjedhur në përputhje me planprogramet mësimore dhe shpërndahet deri tek nxënësit nëpërmjet të RTK 1 e RTK 4, nëpërmjet të platformës emesimi.rks-gov.net që shfaqet në you-tube dhe në platforma të pavarura si material open source (për përdorim të hapur).

Në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-12 të arsimit të mesëm të lartë (si në gjimnaze dhe në shkolla profesionale) mësimi ka filluar vetëm në disa shkolla të mesme private dhe në ndonjë shkollë publike nga mësimdhënësit individualë. Ka edhe drejtori komunale të arsimit që kërkojnë fillimin e punës online në shkollat përkatëse të mesme të larta.

## QËNDRIMI I MASHTI PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA:

Pas shqyrtimit të mundësive të ndryshme përkitazi me mësimin në distancë për arsimin e mesëm të lartë, MASHTI kërkon nga DKA-të të fillojnë përgatitjet dhe inkurajimin e shkollave që të zhvillojnë mësimin në distancë me nxënësit në mënyrë të decentralizuar në nivel shkollë dhe mësimdhënësit në nivel klase. Kërkohet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shkollat përkatëse që të fillojnë përgatitjet për zbatimin e mësimet online prej datës 30 mars 2020 me mundësi që tri ditët e para të shërbejnë për akomodim të mësimdhënësve dhe strukturave.

## UDHËZIME PËR DKA-TË DHE SHKOLLAT:

Kjo formë është më e sigurtë për mësimdhënësit, sepse nuk rrezikojnë largimin nga kushtet e karantinimit ose të distancës sociale (qoftë edhe në rastet kur individualisht prezantojnë nga shkollat).

Kushtet teknologjike: Për këtë kërkohet njohja e aplikacioneve si: Zoom, Microsoft Teams. Mësimdhënësit ose shkollat mund të përcaktohen edhe për aplikacione të tjera si për shembull Facebook, Google Meet, Google Classroom e të tjera. .

Të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë kanë licencë nga qeveria e Kosovës respektivisht nga Agjencia e Shoqërisë Informativë (ASHI). Në anën tjetër, shumica e përdoruesve të Facebook, përfshirë mësimdhënësit, ose janë pjesë e ndonjë grupi të mbyllur në facebook ose kanë krijuar vet ndonjë grup të tillë. Nga mësimdhënësit do të kërkohej të krijonin grupe të tilla me nxënësit dhe të punojnë në zbatimin e mësimet online.

*Vërejtje: Kërkohet nga DKA dhe autoritetet përkatëse arsimore që të udhëzojnë mësimdhënësit në mënyrë strikte për përdorimin e këtyre platformave në përputhje me kriteret më të larta etike të profesionit.*

**Përparësitë:** Nxënësit dhe mësimdhënësit janë më të familiarizuar me këto aplikacione dhe përmes tyre lejohet edhe ndërveprimi dhe shfaqja e audio dhe video materialeve të ndryshme në ekran.

**Vështirësitë:** kërkohet qasja e mirë në internet dhe shkathtësi të një numri të mësimdhënësve për përdorim të aplikacioneve të reja.

MAShTI mund të ofrojë trajnime për mësuesit nëpërmjet të webinarëve të ndryshme, video-materialeve promovuese, përkrahjes teknologjike – sipas nevojës dhe nëpërmjet të sigurimit të qasjes në internet.

## FORMAT PLOTËSUESE

MAShTI ka shqyrtuar modalitete të tjera për të lehtësuar zbatimin e mësimit online në komunitat dhe shkollat që nuk i kanë resurset e mjaftueshme njerëzore e teknologjike për këtë formë të mësimit. Në këtë fazë jemi përcaktuar për dy format në vijim.

1. Realizimi i mësimit online i fokusuar në disa lëndë të përgjithshme:
  - (i) Gjymnazet – zbatimi i kufizuar në lëndët kryesore (gjuhë, matematikë, shkencë natyrore dhe lëndë shorqërore) varësisht nga tipi i gjymnazit. Për shembull gjymnazet gjuhësore do të përqendroheshin në lëndët gjuhë, matematikë dhe gjuhët kryesore, ndërkohë gjymnazet shkencore do të përqendroheshin në gjuhë, matematikë dhe shkencë natyrore e të tjera sipas tipit të gjymnazit.
  - (ii) Shkollat profesionale: Realizojnë mësimin online në lëndët e përgjithshme (gjuhë amtare, matematikë, gjuhë e huaj e të tjera), ndërsa pas rifillimit të mësimit organizojnë mësimin bllok vetëm për lëndët specifike profesionale, praktikën profesionale dhe segmente të lëndëve që kërkojnë punë laboratorike.

Në të dyja rastet e mësipërme nxënësve u njihet mësimi i vijuar online për lëndët kryesore (gjymnaze) dhe lëndët e përgjithshme (në Shkollën profesionale) dhe vazhdojnë në bllok mësimin në lëndët praktike, në lëndët me përmbajtje më specifike profesionale dhe në ato me përmbajtje laboratorike pas rifillimit të mësimit në objekte.

Pas rifillimit të mësimit, mësimdhënësit e lëndëve kryesore e të përgjithshme që kanë realizuar mësimin online, angazhohen në përkrahjen e nxënësve për testimet e duhura (përsëritje, vlerësim, kontrollim i portfoliove etj), dhe në përkrahjen e realizimit të mësimit bllok sipas vlerësimit të menaxhmentit të shkollës.

2. Përdorimi i platformave të tjera (përfshirë në gjuhë të huaja), si për shembull platforma në gjuhën angleze Khan Academy (<https://www.khanacademy.org/>) e cila ofron kurse online të organizuara sipas viteve të shkollimit dhe lëndëve.

MASHTI do të autorizojë edhe platforma të tjera për nivelet përkatëse të shkollimit të cilat nuk janë në kundërshtim me parimet e kurrikulës shtetore të Kosovës.

3. Orientimi i nxënësve të shkollës/komunës përkatëse në platformën elektronike të MASHTI. MASHTI do të bëjë përdorimin e materialeve të mësimit online të disa shkollave të mesme që janë më të avancuara në aspektin teknologjik dhe në zhvillimin e personelit. Në këtë rast, materialet e gjiuara të mësimit në distancë të këtyre shkollave mund të publikoheshin në platformën e materialeve plotësuese të MASHTI dhe do t'u viheshin në dispozicion nxënësve të drejtimeve e të profileve përkatëse. Për shembull, një gjimnaz shkencor në Prishtinë realizon orët sipas planprogramit, i gjiron ato dhe e bartë një link në platformën e MASHTI për materialet plotësuese.